

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5846
E martë, 6 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Kosova
duhet të vendosë vetë
për të gjitha temat
e brendshme **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAI **FAQE 4-5**



PDK-ja nuk bën më kompromise për pozitën e kryeministrit

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, është shprehur i bindur se kjo parti do të dalë fituese nga zgjedhjet e parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se kjo parti më nuk do të lëshojë pe rreth pozitës së kryeministrit. Sipas Hoxhajt, në dy herët e fundit PDK-ja ka bërë kompromise rreth kësaj pozite, duke menduar se edhe nën udhëheqjen e partive të tjera ekzekutivi do të marrë vendime të mëdha për vendin. Hoxhaj ka vlerësuar se historia në vitet e fundit ka treguar se Kosova mund t'i përmbyllë temat e mëdha vetëm nëse qeveria udhëhiqet nga PDK-ja

MË 22 GUSHT SHPËRNDAHET KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Zgjedhjet e parakohshme mbahen në fund të shtatorit ose në fillim të tetorit

Më 22 gusht, në orën 10:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbledhet në seancë plenare për shpërndarjen e Legjislaturës së VI.

Vendimi u mor të hënën në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës së bashku me shefat e grupeve parlamentare. Shpërndarja e



Kuvendit u hapë rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit **FAQE 3**



Mustafa: Nuk jam kandidat për kryeministër **FAQE 3**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE



TRUMPI, THIRRJE PËR
VEPRIME URGJENTE
PËR TA PARANDALUAR
DHUNËN ME ARMË **F. 2**

NË TRI DITËT E FUNDIT,
ASNJË RAST I THUMBUAR NGA
RRIQRAT NË MALISHEVË **F. 10**

KOSNETTI KËRKON QË KOSOVA
TË KTHEHET NË TRYEZËN E
BISEDIMEVE ME SERBINË **F. 7**

EKONOMI

GASHI: TELEKOMI DHE
'Z-MOBILE' TË MERREN
VESH PËR 220 000 NUMRAT
QË JANË NË PËRDORIM **F. 9**

MZHE-ja: TERMOCENTRALI
'KOSOVA E RE' DO TË KETË
NDIKIM TË SHUMËFISHTË NË
PUNËSIM **F. 9**

SPORT



ABAZI: VENDOSA PËR
PRISHTINËN SEPSE ËSHTË
KLUBI MË I MADH NË KOSOVË

F. 15

Meta: Fitoret e thella i gëzojnë liderët politikë, por penalizojnë vendin



TIJANË, 5 GUSHT (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është shprehur të hënën se "fitoret" e pretenduara nga mazhoranca, që ka fituar 100 për qind të bashkive dhe opozita që ka fituar 85 për qind të përkrahjes së shqiptarëve, sjellin pasoja të rënda, që penalizojnë vendin. Sipas Metës, opozita duhet të kishte marrë pjesë në zgjedhje për të arritur një fitore reale dhe institucionale në shumicën dërrmuese të njësive vendore. "Fitoret e thella që gëzojnë liderët

dhe pasojat e rënda që penalizojnë Shqipërinë dhe shqiptarët. E kam fjalën për fitoren 'e vërtetë' të mazhorancës aktuale, që në zgjedhjet e saj të njëanshme dhe të paligjshme, shpalli fitoren në 100 për qind të bashkive të Shqipërisë si dhe të këshillave bashkiakë. Por edhe entuziazmi i liderëve të opozitës, se ata fituan 85 për qind, është mbresëlënëse, duke harruar se sikur opozita të ishte regjistruar në kohë para shfuqizimit të 30 qershorit si datë e zgjedhjeve do t'i mjaftonte të

kishte për vete jo më shumë se 1/4 e 85 për qind për të arritur një fitore reale dhe institucionale në shumicën dërrmuese të njësive vendore. 'Fitoret' e tilla penalizojnë rëndë të ardhmen e vendit, pasi jo vetëm garantojnë një disfatë më 18 tetor për hapjen e negociatave në mënyrë të sigurt, por lënë pa mbrojtje nga të drejtat e tyre të gjithë qytetarët shqiptarë të cilët jetën e tyre të përditshme e kanë aq të lidhur me shërbimet e pushtetit vendor", ka thënë Meta.

Gjykatës në Shkup i dorëzohet kërkesa e Serbisë për ekstradimin e Tomor Morinës

"Epoka e re"

SHKUP, 5 GUSHT - Ministria e Drejtësisë e Maqedonisë së Veriut i ka dorëzuar Gjykatës Themelore "Shkupi 1" kërkesën e Serbisë për ekstradimin e ish-pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Tomor Morina. Siç bëhet me dije nga gjykata, ministria ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin lidhur me procedurën e ekstradimit të Tomor Morinës të cilit më 25 korrik iu caktua masa e paraburgimit.

Gjykatësi i procedurës paraprake do të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore dhe mendimin do ta dërgojë në gjykatën kompetente që të vendosë dhe e cila më pas përgjigjen do t'ia dërgojë Ministrisë së Drejtësisë që është përgjegjëse për procedurën e mëtejme të ekstradimit.

Gjykata penale njoftoi se i ka lejuar një delegacioni të Ambasadës së Kosovës që ta vizitojë Morinën i cili ndodhet në burgun e Shkupit. Morina ishte arrestuar nga policia maqedonase më 24 korrik, në bazë të një fletarrestimi të Interpolit, të lëshuar me kërkesë të Serbisë.

Morina dyshohet nga ana e autoriteteve të Serbisë se para 20 vjetëve, si pjesëtar i UÇK-së, ka bërë krime kundër popullatës civile në Kosovë.

Për ekstradimin e Morinës ka folur edhe ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj. Ai ka thënë se ekstradimi nuk duhet të vijë në shprehje pasi, siç ka thënë, mund të ndodhë prishja e marrëdhënieve ndërshtetërore në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. "Megjithatë, kujtoj se ekstradimi i tij komplet kundër të drejtave njerëzore është antiligjor, i papranueshëm dhe nuk do të



duhej të ndodhte sepse një ekstradim eventual nuk është më në dëm të fatit personal të Tomor Morinës, por mund të ketë pasoja edhe për marrëdhëniet ndërshtetërore në mes të Republikës së Kosovës dhe

Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk do të donim që raste të tilla të ndikojnë për prishjen eventuale, për çka nuk jemi të interesuar fare si Kosovë", ka thënë Dedaj.

Para disa ditësh ministri i

Drejtësisë, Abelard Tahiri, i është drejtuar me letër ministres së Drejtësisë të Maqedonisë së Veriut, Renata Deskoska, nga e cila ka kërkuar shqyrtimin e aspekteve ligjore dhe rrethanave të tjera për lirin e Tomor Morinës.

Trumpi, thirrje për veprime urgjente për ta parandaluar dhunën me armë

UASHINGTON, 5 GUSHT - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka bërë thirrje për veprime urgjente për ta parandaluar dhunën me armë. Ai ka thënë të hënën se të gjithë amerikanët duhet ta "dënojnë racizmin, fanatizmin dhe supremacizmin e bardhë". Kjo deklaratë e Trumpit vjen pas vrasjeve masive me armë zjarri në Teksas dhe Ohajo, ku humbën jetën 29 veta dhe u plagosën dhjetëra të tjerë. "Këto ideologji të gabuara duhet të mposhten", ka thënë presidenti Trump në shtëpinë e Bardhë. "Urrejtja nuk ka vend në Amerikë. Urrejtja

mjegullon mendjen, shkatërron zemrën dhe gllabëron shpirtin", ka thënë ai.

Të shtunën një njeri i armatosur vrau 20 veta në një Walmart të El Pasos në Teksas, ngjarje që autoritetet e quajtën krim të urrejtjes me motive racore. Vetëm 13 orë më vonë një tjetër njeri i armatosur në qendër të Dejttonit, në shtetin Ohio, vrau nëntë njerëz. Presidenti Trump ka pohuar se ligjet e shëndetit mendor duhet të reformohen për t'i identifikuar më mirë individët me probleme mendore. Ai bëri thirrje për zbatimin e dënimit kapital për ata që kryejnë

vrasje masive dhe krime të urrejtjes. Trumpi ka bërë me dije se kishte udhëzuar Departamentin e Drejtësisë të punojë me autoritetet lokale dhe kompanitë e mediave sociale për t'i zbuluar vrasësit para se të godasin. Ai ka theksuar se interneti, media sociale dhe videolojërat e dhunshme kanë ndihmuar në radikalizimin e njerëzve. Presidenti Trump u ka kërkuar ligjvënësve të vendosin kontrolle të forta mbi blerësit e armëve, duke lënë të kuptohet se kjo mund të bëhet paralelisht me reformën e imigracionit.



Më 22 gusht shpërndahet Kuvendi i Republikës së Kosovës

Zgjedhjet e parakohshme mbahen në fund të shtatorit ose në fillim të tetorit



Më 22 gusht, në orën 10:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbledhet në seancë plenare për shpërndarjen e Legjislaturës së VI. Vendimi u mor të hënën në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës së bashku me shefat e grupeve parlamentare. Shpërndarja e Kuvendit u hapë rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 GUSHT - Më 22 gusht, në orën 10:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbledhet në seancë plenare për shpërndarjen e Legjislaturës VI. Kështu vendosi të hënën në mënyrë konsensuale kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbledhjen e drejtuar nga kryetari Kadri Veseli, në të cilën morën pjesë edhe shefat e grupeve parlamentare. Seancës do t'i paraprijë mbledhja e nënshkrimeve të nevojshme të deputetëve. Në seancën e 22 gushtit, para

shpërndarjes së Legjislaturës VI, pikë e rendit të ditës do të jetë edhe votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Pas përfundimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ka folur Kadri Veseli. Ai në adresimin për media ka falënderuar shefat e grupeve parlamentare që i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së tij për këtë takim. Veseli ka thënë se në këtë mbledhje të kryesisë së Kuvendit pati vendime konsensuale si vendimi për caktimin e 22 gushtit për shpërndarjen e Kuvendit. Kryeparlamentari Veseli ka thënë

se e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet e parakohshme. "Ky vend ka nevojë për vendosmëri për të ecur përpara", është shprehur ai. Ai ka shtuar se vendit i duhet edhe mençuri strategjike për ta ruajtur shtetin, sovranitetin dhe integritetin. "Me këtë vendim (për shpërndarje të Kuvendit) kemi treguar para qytetarëve një shpresë se Kosova ka perspektivë", ka deklaruar Veseli. Kryeministri në largim Ramush Haradinaj ka mirëpritur vendimin e kryesisë për shpërndarjen e Kuvendit më 22 gusht. Ai ka thënë se ky vendim do t'i hapë rrugë procesit zgjedhor në vend si opsion i vetëm dhe i domosdoshëm. Po ashtu, Haradinaj ka përhëndetur vendimin e kryesisë që para shpërbërjes, Kuvendi të votojë për Marrëveshjen Ndërkombëtare IPA2 nga e cila Kosova fiton rreth 90 milionë euro fonde nga BE-ja. "Vendimi i kryesisë së Kuvendit për të mbajtur seancë më 22 gusht 2019, për shpërbërjen e Kuvendit, është veprim i duhur dhe konform ligjeve dhe Kushtetutës së vendit. Ky vendim do t'i hapë rrugë procesit zgjedhor në vend si opsion i

vetëm dhe i domosdoshëm. Po ashtu, është për t'u përhëndetur vendimi i kësaj kryesie, që para shpërbërjes, Kuvendi të votojë për Marrëveshjen Ndërkombëtare IPA2, nga e cila Kosova fiton rreth 90 milionë euro fonde nga BE-ja. Kthimi i mandatit të sovranit dhe zgjedhjet e lira dhe demokratike janë jetike për vendin dhe për proceset e rëndësishme që na presin", ka thënë Haradinaj. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se Kuvendi i Kosovës shpërndahet në seancën e 22 gushtit. "Në atë seancë, me propozim edhe të LDK-së, do të votohet marrëveshja IPA me BE-në prej 100 milionë eurosh. Menjëherë pas seancës caktohet data e zgjedhjeve, ku qytetarët vendosin kush duhet ta udhëheqë Kosovën. Kjo legjislaturë e Kuvendit duhet të jetë mesim për tjerat që vijnë, se nuk mund të qeveriset vendi pa legjitimitet politik dhe pa shumicë parlamentare, nuk mund të qeveriset me njerëz që nuk përfaqësojnë asgjë përveç interesave të caktuara", ka thënë Hoti. Ndërkaq shefi i grupit parlamen-

tar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, ka thënë se fundi i shtatorit ose fillimi i tetorit do të jetë koha më e përafërt për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Ai ka theksuar se pas shpërndarjes së Kuvendit është në diskrecion të presidentit Hashim Thaçi se kur vendos ta caktojë datën e zgjedhjeve të reja, duke kujtuar afatin kushtetues të 30 ditëve. "Brenda 30 ditëve është në diskrecion të presidentit", ka deklaruar Sherifi. Sipas Kushtetutës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit ndodh me dy të tretat e votave (2/3). Ndërkaq, jo më herët se tridhjetë ditë dhe më vonë se dyzetepesë ditë pas shpërndarjes së Kuvendit duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme. Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës u hap rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit. Haradinaj ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë më 19 korrik, meqë ka marrë ftesë për intervistim nga Gjykata Speciale në Hagë, në cilësinë e të dyshuarit.

Mustafa: Nuk jam kandidat për kryeministër

Prishtinë, 5 gusht - Lideri i zgjedhur për herë të tretë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se ai nuk e ka ndërmend të jetë kandidat i kësaj partie për kryeministër dhe se partia do të zgjedhë një person që e "bën më së miri këtë punë dhe natyrisht që ka përkrahjen e

plotë të LDK-së dhe të qytetarëve". Duke folur në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Mustafa ka thënë se partia që ai udhëheq dëshiron të shkojë e vetme në zgjedhje, por ky qëndrim mund të ndryshojë dhe varet se si veprojnë partitë e tjera. Mustafa thotë se bisedimet

me Serbinë duhet t'i udhëheqë kryeministri në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Taksa duhet të vazhdojë derisa Serbia të mos ndërrojë qëndrimet e veta dhe përderisa mos të reflektojë në të gjitha këto sjellje të bllokadës që po i bën Kosovës", ka thënë Mustafa.



Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

PDK-ja nuk bën më kompromis



Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, është shprehur i bindur se kjo parti do të dalë fituese nga zgjedhjet e parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se kjo parti më nuk do të lëshojë pe rreth pozitës së kryeministrit. Sipas Hoxhajt, në dy herët e fundit PDK-ja ka bërë kompromise rreth kësaj pozite, duke menduar se edhe nën udhëheqjen e partive të tjera ekzekutivi do të marrë vendime të mëdha për vendin. Hoxhaj ka vlerësuar se historia në vitet e fundit ka treguar se Kosova mund t'i përmbyllë temat e mëdha vetëm nëse qeveria udhëhiqet nga PDK-ja

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 GUSHT - Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se kjo parti më nuk do të bëjë kompromise për pozitën e

kryeministrit. Ai ka deklaruar se kjo parti në dy mandatet e fundit ka lëshuar pe rreth kësaj pozite duke menduar se edhe partitë e tjera duke e udhëhequr ekzekutivin mund të marrin vendime të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka thënë se në vitet e fundit kanë

treguar se vetëm një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja mund ta përmbyllë procesin e shtetndërtimit. "Absolutisht jo. Mendoj se në të kaluarën kompromise të tilla PDK-ja ka bërë me idenë që ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës, mirëpo historia në vitet e fundit ka treguar se Kosova

mund t'i përmbyllë temat e mëdha dhe mund të marrë vendime të mëdha vetëm nëse PDK-ja është e madhe dhe nëse Qeveria e Kosovës udhëhiqet nga kryetari i PDK-së, z. Veseli. Këtu ka një qartësi të plotë në PDK", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka vlerësuar se pa rolin vendimtar të kësaj partie nuk mund të mbyllet faza e shtetndërtimit të Kosovës. "Ne duhet ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës. Faza në të cilën është aktualisht Kosova nuk mund ta gjejë fundin e saj dhe përmbylljen e saj pa rolin vendimtar që ka PDK-ja si parti më e madhe në vend", ka deklaruar Hoxhaj. Ai është shprehur i bindur se nga zgjedhjet e parakohshme kjo parti

do të dalë fituese dhe kryeministër i ardhshëm i Kosovës do të jetë lideri i PDK-së, Kadri Veseli. Hoxhaj ka treguar se parimisht PDK-ja duhet të shkojë e vetme në zgjedhjet të cilat pritet të mbahen në vjeshtë. "Mendoj se ky është një vendim që i takon kryetarit dhe kryesisë së PDK-së. Deri më tani nuk kemi pasur një debat të tillë, por parimisht mendojmë se duhet të shkojmë të vetëm në këto zgjedhje, ndoshta me ndonjë bashkëpunim me ndonjë subjekt më të vogël. Mirëpo, siç thashë, këto janë çështje që i takojmë kryesisë së PDK-së. Koalicioni i vetëm që ne kemi në këto zgjedhje është koalicioni me qytetarët e Kosovës, diçka që historikisht

e për pozitën e kryeministrit

gjendje që t'i përmbyllë pritjet që i ka qytetari i Kosovës. Si çdoherë, PDK-ja është parti e cila përcakton dinamikën në këtë vend. Ne kemi vendosur që ta ftojmë kryesinë e Kuvendit për ta caktuar këtë datë. Në këtë mënyrë mendoj se zgjedhjet duhet të mbahen sa më shpejt. Tani i takon presidentit që ta caktojë datën e zgjedhjeve.

"Epoka e re": Nëse Kuvendi shpërndahet më 22 gusht, sipas afatit kushtetues, i bie që zgjedhjet mund të mbahen në fund të shtatorit apo në fillim të tetorit. Për PDK-në, cila do të ishte koha më e mirë e mbajtjes së zgjedhjeve?

Hoxhaj: Caktimi i datës së mbajtjes së zgjedhjeve i takon presidentit të vendit. Ai këtë mund ta caktojë në bashkëpunim me të gjitha subjektet politike. Ne si PDK jemi të gatshëm për këto zgjedhje. PDK-ja është parti që ka përmbyllur procesin e brendshme zgjedhor, ku rreth 50 mijë anëtarë të PDK-së kanë marrë pjesë në këtë proces në nivel të degëve dhe nëndegëve. Kështu që, ne jemi të gatshëm edhe në kuptimin organizativ, por edhe në kuptimin përmbajtësor se çfarë do të duhet të prezantojmë në këto zgjedhje. Caktimi i datës i takon presidentit të vendit.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet e PDK-së për këto zgjedhje?

Hoxhaj: Pa dyshim ne jemi partia më e madhe në vend. Jemi parti që në këta 20 vjet të lirisë dhe në këta 11 vjet të pavarësisë e ka trashëgiminë më të madhe politike, me rezultate konkrete. Në zgjedhje ne nuk do të flasim për histori, por do të flasim për aktualitetin, për pritjet që i kanë qytetarët dhe për temat që janë shqetësimet kryesore të qytetarëve. Do të kemi një platformë jashtëzakonisht të mirë dhe koncize, e cila i përshkruan pritjet që i ka qytetari i Kosovës. Besoj se para se të fillojë fushata zgjedhore do ta prezantojmë një platformë të tillë, ku do të shohin qytetarët se çka pret PDK-ja prej këtyre zgjedhjeve. Paraprakisht dua të them se ne duhet ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës. Faza në të cilën është aktualisht Kosova nuk mund ta gjejë fundin e saj, përmbyllet e saj, pa rolin vendimtar që ka PDK-ja si partia më e madhe në vend.

"Epoka e re": A e keni menduar se si do të shkojë PDK-ja në këto zgjedhje? Me ndonjë koalicion parazgjedhor apo e vetme?

Hoxhaj: Mendoj se ky është një vendim që i takon kryetarit dhe kryesisë së PDK-së. Deri më tani nuk kemi pasur një debat të tillë, por parimisht mendojmë se duhet të shkojmë të vetëm në këto zgjedhje, ndoshta me ndon-

jë bashkëpunim me ndonjë subjekt më të vogël. Mirëpo, siç thashë, këto janë çështje që i takojmë kryesisë së PDK-së. Koalicioni i vetëm që ne kemi në këto zgjedhje është koalicioni me qytetarët e Kosovës, diçka që historikisht PDK-ja ka bërë edhe në të kaluarën.

"Epoka e re": Mund të pritjet që sërish, për shkak të ndonjë koalicioni, PDK-ja të lëshojë për postin e kryeministrit siç ka ndodhur herën e fundit?

Hoxhaj: Absolutisht jo. Mendoj se në të kaluarën kompromise të tilla PDK-ja ka bërë me idenë që ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës, mirëpo historia në vitet e fundit ka treguar se Kosova mund t'i përmbyllë temat e mëdha dhe mund të marrë vendime të mëdha vetëm nëse PDK-ja është e madhe dhe nëse

Qeveria e Kosovës udhëhiqet nga kryetari i PDK-së, z. Veseli. Këtu ka një qartësi të plotë në PDK.

"Epoka e re": Domethënë në këtë pikë PDK-ja më nuk bën asnjë kompromis?

Hoxhaj: Mendoj se isha mjaft i qartë në përgjigje.

"Epoka e re": Meqenëse nuk janë përmbyllur temat e mëdha në këto dy mandate, a do të thotë se PDK-ja i ka rënë pishman që ua ka dhënë pozitën e kryeministrit LDK-së dhe AAK-së?

Hoxhaj: Nuk mendoj se vlerësimet e tilla morale vlejshme shumë në politikë. Ajo se çfarë ne kemi menduar se është e drejtë, është se për idenë e shtetndërtimit të Kosovës çdoherë kemi kërkuar partneritet me parti të cilat mund t'i përmbyllim vendimet e mëdha. Por, nga viti

2014 e kemi parë që vetëm nën udhëheqjen e PDK-së, dhe kjo është tradita jonë, qeveritë mund të marrin vendime të mëdha. Pra, vetëm nën udhëheqjen e PDK-së qeveritë kanë dinamikë. Këtu nga ana jonë është më se e qartë se kryetari i PDK-së do të jetë edhe kandidati ynë për kryeministër, dhe z. Veseli do të jetë kryeministër i ardhshëm i vendit.

"Epoka e re": Gjatë kësaj qeverie keni qenë zëvendëskryeministër. Kjo qeveri i ka përmbyllur objektivat e PDK-së?

Hoxhaj: Mendoj se disa prej vendimeve të cilat i kemi marrë kanë qenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës, ndërsa një vlerësim të përgjithshëm do ta thosha në fund të vitit nëse qeveria do të qëndronte deri në dhjetor.

Ministri Tahiri: Do të kujdesemi që Lugina e Preshevës mos të mbetet luginë e dëshpërimit

Faton DËRAMKU

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa. Ministri Tahiri ka thënë se Republika e Kosovës dhe institucionet e saj duhet ta kenë një agjendë të mirëfilltë dhe sistematike që adreson çështjet e popullit shqiptar në Luginën e Preshevës, në mënyrë që komuniteti shqiptar që jeton në atë pjesë, të rigjenerohet edhe në planin socio-ekonomik edhe në atë socio-politik e kulturor. "Për shkak të përbërjes etnike Luginë e Preshevës vazh-

don të mbetet një ndër rajonet më të diskriminuara në Evropën Juglindore si pasojë e politikës dezintegruese të Serbisë dhe kjo nuk mund të tolerohet brenda një vendi që aspiro Bashkimin Evropian. Në takim të përzemërt me kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar, z. Ragmi Mustafa, ndamë bashkërisht perspektivën për hapat e mëtejshme që duhet t'u paraprijmë, për të arritur kështu rezultate konkrete dhe një lidhje shumë më të fuqishme në mes të institucioneve tona dhe qytetarëve që jetojnë në atë pjesë. Luginë e Preshevës nuk mund të mbetet luginë e dëshpërimit dhe as e shpopullimit. Ajo ka nevojë për mbështetjen tonë dhe sensibi-

lizimin tonë në rrafshin ndërkombëtar për kufizimet e njëpasnjëshme që pushteti serb i vendos ndaj kësaj zone", është shprehur Tahiri. Ai ka theksuar se Luginë e Preshevës ka nevojë për investime dhe për edukim. "Ne kemi obligim që ndaj kësaj pjese të banuar me shqiptarë ta stimulojmë zhvillimin ekonomik dhe social dhe kultivimin më të fuqishëm të lidhjeve tona kulturore. Republika e Kosovës aspiro relacione të shëndosha me vendet fqinje dhe trajtimi i popullsisë shqiptare brenda këtyre vendeve është kapitulli më thelbësor që do t'i përcaktojë këto relacione", ka deklaruar Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë.



PDK-ja ka bërë edhe në të kaluarën", është shprehur Hoxhaj.

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që më 22 gusht të shpërndahet Kuvendi. Cili është qëndrimi i PDK-së për këtë çështje?

Hoxhaj: Qëndrimi i PDK-së rreth kësaj çështje është qartësuar para disa ditësh, kur kryetari i Kuvendit mori vendim ta ftojë kryesinë e Kuvendit me një pikë të vetme të rendit të ditës, që ishte shpërndarja e kësaj legjislature. Ne kemi vlerësuar se nuk mund të ketë një qasje të blerjes së kohës, nuk mund të ketë një vakum institucional dhe nuk mund të ketë një arnim të qeverisë. Pra, një lloj qeverie e cila nuk do të ishte në

Përfundon trajnimi 'Përcaktimi i zonës së aterimit të helikopterit'



Ushtarët e FSK-së i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHINË, 5 GUSHT - Në Ministrinë e Mbrojtjes ka filluar të hënën aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut, sesioni i dytë për këtë vit, për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku të Kosovës dhe nëpërmjet saj për pacientët në nevojë. Ushtarakë dhe civilë, gra e burra, punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes pa dallim në detyra dhe grada, iu përgjigjen masivisht aksionit humanitar për dhurimin e gjakut, disa edhe për të dytën herë brenda këtij viti, e shumica prej tyre tanimë janë dhurues të rregullt.

Dhurues i rregullt vullnetar është edhe gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, drejtor i drejtorisë së Operacioneve, i cili së bashku me stafin tjetër të Ministrisë së Mbrojtjes i përgjigjen çdoherë

këtij aksioni shumë human. Mbarëvajtjen e aksionit nga afër e përcollën kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, drejtor i departamentit për Çështje Mjekësore në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe drejtoresha e Qendrës Kombëtare për Transfuzionin e Gjaku, dr. Bukurije Zhubi. Aksioni humanitar i dhurimit vullnetar të gjakut, i dyti për këtë

vit, po zhvillohet bazuar në planin e veprimit për vitin 2019 të drejtorisë për Politika dhe Plane, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak dhe Drejtorisë së Operacioneve/ Departamenti për Çështje Mjekësore dhe do të vazhdojë të zhvillohet në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës deri më 2 shtator 2019.



FUSHË KOSOVË, 5 GUSHT (ER) - Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim Shpëtim (QTKSH) të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), në kazermën "Evropianët e rinj" në Pomozatin, është mbajtur ceremonia e certifikimit të kursit "Përcaktimi i zonës së aterimit të helikopterit".

Shefi i Shtabit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile, nënkolonel Shpend Zogaj, u shpreh shumë i kënaqur që Qendra e Trajnimit po arrin ta përmbushë gradualisht vizionin për një qendër me perspektivë rajonale dhe më gjerë.

Në këtë trajnim u trajtuan tema që lidhen me aerodinamikën dhe funksionimin e helikopterëve. Në veçanti, studentët u njoftuan me kriteret e përzgjedhjes së një zone të përshtatshme për

atterrim të helikopterëve, me komandat dhe sinjalet e komunikimit me pilotin para aterimit, si dhe mënyrën e evakuimit mjekësor duke përdorur formatin e kërkesës së quajtur "NATO nëntë linjat". Po ashtu, studentët mësuan parimet themelore të bartjes së viktimave me helikopter.

Pjesë kyçe të këtij trajnimi ishin njohuritë e sjella nga pilotët e FSK-së, togerët Afrim Zabeli, Krenar Voca, Atdhe Hasani nga Komanda e Forcave Tokësore. Ata me ekspertizën e pilotimit të helikopterit sollën njohuritë e tyre të dobishme rreth aerodinamikës së fluturakeve - helikopterëve. Gjithashtu, oficerët pilotë në detaje ofruan njohuritë e tyre rreth procedurave që duhen ndjekur për të përcaktuar një zonë për aterrim të helikopterit.

Gashi në manifestimin qendror falënderon diasporën për përkrahjen e vazhdueshme

SKENDERAJ, 5 GUSHT (ER) - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt u mbajt manifestimi qendror për diasporën. Manifestimi nisi me homazhet në varrezat e Jasharëve në Prekaz, për të vazhduar më pas në Sheshin "Adem Jashari" të Skenderajt me një koncert për diasporën.

Në fjalën e tij, zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër i Diasporës, Dardan Gashi, ka falënderuar bashkatdhetarët për

kontributin e vazhdueshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për vendlindjen e tyre - Kosovën. "Unë ju falënderoj përzemërsisht që vazhdoni të jeni shtylla mbështetëse e vendlindjes suaj, e Kosovës. Faleminderit për ndihmën e madhe që i jepni vendlindjes në zhvillimin ekonomik", ka theksuar Gashi. Bekim Jashari, kryetar i Komunës së Skenderajt, u uroi mirëseardhje bashkatdhetarëve. "Vendlindja si gjithmonë ju pret me duar të hapura për kontributin që keni dhënë në të gjitha etapat e

historisë", ka thënë Jashari.

Ai ka treguar për aktivitetet që do të zhvillohen për bashkatdhetarët.

Një fjalë rasti mbajti edhe Pandeli Majko, ministër i Diasporës i Shqipërisë.

Pas fjalëve përshëndetëse, nisi koncerti me këngëtarët Shaqir Cërvadiku, Shkumbin Ismajli, Bukurie Azizaj-Avdullahu dhe Fatmir Berisha. Këtij koncerti ia shtoi madhësinë edhe ansambli "Drenica" nga Skenderaj, i cili ekzekutoi valle të njohura shqiptare.



Haradinaj: Kosova duhet të vendosë vetë për të gjitha temat e brendshme

Republika e Kosovës duhet ta përmbyllë shtetësinë dhe të bëhet shtet qind për qind. Kështu ka deklaruar të hënën kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, gjatë një bashkëbisedimi me qytetarë në Mitrovicë. Ai ka thënë se ka ardhur koha që Kosova të bëhet vetvetja dhe të vendosë vetë për të gjitha temat e brendshme. Haradinaj ka deklaruar se në aspektin e brendshëm është i rëndësishëm forcimi i rendit dhe ligjit, siguria, zhvillimi ekonomik si dhe krijimi i vendeve të punës

vendeve të punës. Po ashtu, Kosova nuk e ka përmbyllur qind për qind shtetësinë në planin e jashtëm sepse nuk është pjesë e NATO-s dhe nuk është anëtarësuar në OKB dhe organizata të tjera. Për të ecuar në planin e jashtëm kuptohet se ka peshë dialogu, pra këtu vjen pesha e dialogut", është shprehur Haradinaj.

Më tutje, ai ka folur para të pranishmëve për dorëheqjen e tij dhe shkuarjen e vendit në zgjedhje duke thënë se mandatin e ka kthyer te qytetarët. "Në situata të tilla mandati është te vendim-marrja dhe personi që e ka këtë mandat, në këtë rast kryetari i qeverisë, vendos kujt dëshiron t'ia kthejë. Ai mund ta japë mendimin e vet, është e rregulluar me Kushtetutë, ligje, por mund ta thotë edhe mendimin e vet. Unë kam preferuar që mandatin t'ia kthej popullit", ka theksuar Haradinaj, duke shtuar se një kryetar qeverie nuk jep dorëheqje për t'u kthyer prapë aty. "Sigur të kish ekzistuar një situatë më lart, do të kishte dhënë dorëheqje për kalkulime të vogla politike për të shkuar një

hap më lart, por një kryetar qeverie nuk jep dorëheqje për t'u kthyer sërish aty. Është gabim interpretimi i kujtdo qoftë, keqpërdorim dhe mungesë e një gjykimi të drejtë pse ka dhënë dorëheqje", ka deklaruar kryeministri.

Haradinaj ka thënë se nuk ka mundur ta çojë shtetin para hetuesve jashtë vendit sepse, sipas tij, në këtë mënyrë do ta dobësonte Kosovën si dhe do të krijonte precedent shumë të keq për gjithë nocionin e sovranitetit të shtetit. "Fakti që unë kam dhënë dorëheqje, e kam mbrojtur Kosovën në planin ndërkombëtar, sepse ka dalë lajmi që kryeministri i Kosovës dha dorëheqje sepse është ftuar si i dyshuar. Është e vërtetë që nuk kam aktakuzë, por jam ftuar si i dyshuar dhe kam dhënë dorëheqje", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, institucionet duhet t'i kryejnë punët e veta deri në mbajtjen e zgjedhjeve dhe konstituimin e institucioneve të reja. "Kosova ka plot tema në tavolinë dhe për to mirë është që të mos humbet kohë dhe e rëndësishme është që po shkon në kohë të

rregullt kohore kushtetuese mbajtja e zgjedhjeve", ka thënë ai.

Gjatë debatit në Mitrovicë kryeministri në largim ka folur edhe për projektet që Qeveria e Kosovës ka realizuar në Komunën e Mitrovicës, me ç'rast ka përmendur përfundimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë në vlerë prej 53 milionë eurosh; parkun energjetik me vlerë 169 milionë euro investim, hapjen e segmentit të rrugës Smrekovicë - Mitrovicë; procesin e rehabilitimit të hekurudhës Prishtinë - Mitrovicë; inaugurimin e nënstationit për energji elektrike; rregullimin e shtretërve të lumenjve, ndërtimin e shkollave, rregullimin e terreneve sportive dhe projekte të tjera. Gjithashtu, kryeministri Haradinaj u është përgjigjur edhe pyetjeve të qytetarëve që kishin të bënin me zhvillimet e fundit politike, zgjedhjet dhe koalicionet parazgjedhore, çështjen e pensioneve të punëtorëve të viteve '90, zhvillimin ekonomik, arsimin dhe shumë çështje të tjera me rëndësi për qytetarët e Komunës së Mitrovicës.

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë të hënën se ka ardhur koha që Kosova të vendosë vetë për të gjitha temat e brendshme. Ai ka deklaruar se Kosova duhet ta përmbyllë shtetësinë në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë që të bëhet shtet qind për qind. "Kosova duhet të vazhdojë ta përmbyllë shtetësinë brenda, pra të bëhet shtet qind për qind. Ka ende punë për t'u

bërë shtet qind për qind, mirëpo duhet bërë vetvetja dhe të vendosë vetë për krejt temat e brendshme", ka deklaruar Haradinaj gjatë një bashkëbisedimi për qytetarë në komunën e Mitrovicës.

Ai ka thënë se në aspektin e brendshëm është i rëndësishëm forcimi i rendit dhe ligjit dhe zhvillimi ekonomik, kurse në aspektin e jashtëm ka peshë edhe dialogu. "Në aspektin e brendshëm është i rëndësishëm forcimi i rendit dhe ligjit, siguria, zhvillimi ekonomik dhe krijimi i



Kosnetti kërkon që Kosova të kthehet në tryezën e bisedimeve me Serbinë

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të hënën ka pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett. Në komunikatën për medie të LDK-së është thënë se në këtë takim janë diskutuar tema të rëndësishme për vendin, me theks të veçantë për zgjedhjet e brendshme të LDK-së dhe situata aktuale politike. "Kryetari Mustafa e njoftoi

ambasadorin Kosnett për ecurinë e procesit zgjedhor të LDK-së dhe theksoi se Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson që vendi duhet të shkojë në zgjedhje të përgjithshme sa më parë. LDK-ja ka përgatitur programin qeverisës për qeverinë e re ku prioritet do të jenë luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmbyllja e dialogut me Serbinë, përshpejtimi i proceseve integruese në strukturat euroatlantike, zhblokimi i potencialit ekonomik përmes

përkrahjes së sektorit privat etj", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Në vazhdimin e kësaj komunikate është bërë me dije se ambasadori Kosnett ka thënë se është e rëndësishme që Kosova ta ruajë fokusin e vet për fuqizimin e sundimit të ligjit, kthimit në tryezën e bisedimeve me Serbinë, për të arritur normalizim dhe për të krijuar mundësi të cilat u lejojnë qytetarëve të Kosovës të kontribuojnë në ardhmërinë e Kosovës.



Matoshi: Deputetët duhet të votojnë fondet e IPA-s para shpërndarjes së Kuvendit

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka deklaruar se deputetët e Kuvendit të Kosovës para shpërndarjes së Kuvendit duhet të votojnë për fondet e IPA-s. Matoshi ka thënë se 78 milionë euro fonde nga IPA janë shumë të rëndësishme për Kosovën, pasi aty parashihen disa investime të

mëdha për vendin. "Përtej lëvizjeve politike dhe thirrjes së seancës për shpërbërjen e Kuvendit, është tepër me rëndësi për vendin që marrëveshjet ndërkombëtare të miratohen në Kuvend para se ai të shpërbëhet. Janë 78 milionë euro nga fondet IPA, të destinuara për ndërrimin e filtrave të Kosovës B, është projekti 15 milionë dollarë i

Bankës Botërore për kadastrë dhe fonde të tjera mjaft të rëndësishme për mjedisin dhe Kosovën në përgjithësi që nuk duhet të mbesin pa realizuar për shkak të zhvillimeve politike në Kosovë. Këto projekte janë shumë të rëndësishme si për pozitën, po ashtu edhe për opozitën, sepse ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të vendit", ka shkruar Matoshi.



MZHE-ja: Termocentrali 'Kosova e Re' do të ketë ndikim të shumëfishtë në punësim

Gjatë fazës së ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re" do të krijohen rreth 10 000 vende direkte të punës, si dhe mijëra vende indirekte të punës si rezultat i furnizimeve në termocentral, duke nxitur zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe social të vendit



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 GUSHT - "Kosova e Re do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik e social në Kosovë, do ta eliminojë varshmërinë nga importet dhe humbjet e vazhdueshme në ekonomi si pasojë e mungesës së energjisë", kështu është thënë në njoftimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Sipas këtij njoftimi, vetëm gjatë fazës së ndërtimit do të krijohen rreth 10 000 vende direkte të punës si dhe mijëra vende indirekte të punës si rezultat i furnizimeve në termocentral, duke nxitur zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe social të vendit. "Me të përfunduar ndërtimi dhe


kur termocentrali bëhet operacional, do të krijohen qindra vende pune afatgjata, me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes së impiantit të ri. Po ashtu, me ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re' garantohet vazhdimi i ekzistimit të industrisë minerare të thëngjillit në Kosovë, e cila për dekada ka ndikim shumëdimensional në qëndrueshmërinë ekonomike të vendit, nga ku do të ruhen dhe gjenerohen vende pune për 40 vjetët e ardhshëm të operimit të termocentralit të ri", thuhet në njoftimin e MZHE-së, duke u shtuar se përkundër të qenit vendi i tretë për nga rezervat e thëngjillit në Evropë, pas dy dekadash përballjeje me mungesë të ashpër të energjisë

elektrike, Kosova ka nënshkruar marrëveshje me kompaninë Amerikane "ContourGlobal", për ta zhvilluar projektin e termocentralit të ri në vend. "Të dyja kanë njoftuar mbi përzgjedhjen e gjigantit Amerikan 'General Electric' për kontratën e inxhinierimit, prokurimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes

afatgjatë të termocentralit të ri, që pritet të sjellë mjaftueshëm rrymë për furnizim të rregullt dhe zhvillim të hovshëm ekonomik. Ndryshe, në mungesë të termocentralit të ri dhe projekteve të tjera të energjisë së ripërtrishme, pas mbylljes së termocentralit 'Kosova A', vendi mund të për-

ballet me mungesë të dukshme të energjisë elektrike. Si rrjedhojë, asaj i duhet të varet në importe për furnizim me rrymë në vend. Raportet zyrtare theksojnë se vetëm në dhjetë vjetët e fundit Kosova ka importuar mbi gjysmë miliardi euro energji elektrike", është thënë në njoftimin e MZHE-së.

Kreditimi për sektorin e prodhimit në Kosovë pati ngritje për 20 për qind



PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Shoqata e Bankave e Kosovës (ShBK) përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se kreditimi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 për sektorin e prodhimit dhe bujqësisë në Kosovë ka shënuar ngritje të konsiderueshme në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

Në krahasim me tremujorin e dytë (TM2) të vitit paraprak, kreditimi për sektorin e prodhimit në Kosovë pati ngritje prej 20 përqindësh, ndërsa rritje pati edhe sektori i bujqësisë prej 15.4 përqindësh. Sipas statistikave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, kreditimi për sektorin e prodhimit për gjashtëmujorin e

parë të vitit 2019 ishte 242.30 milionë euro, ndërsa për sektorin e bujqësisë ishte 74.00 milionë euro.

Kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se rritja e kërkesës për kreditim nga ana e sektorit të prodhimit dhe bujqësisë në Kosovë paraqet një momentum të ri jo vetëm në sektorin bankar në Kosovë, por edhe për vetë zhvillimin ekonomik të vendit pasi, sipas tij, gatishmëria e bankave për t'u ofruar kredi bizneseve me norma të ulëta të interesit me kushte të favorshme preferenciale, hap mundësi të reja për krijime të vendeve të punës dhe krijon rrugë të reja për eksport. Krahas rritjes së kreditimit për

sektorin e prodhimit dhe bujqësisë, Balija ka deklaruar se sektori bankar në Kosovë është duke bërë përpjekje të vazhdueshme të përkrahë edhe sektorë të tjerë ekonomikë përmes kreditimit, në mënyrë që të krijohen kushte të favorshme për të gjitha industritë në vend. "Rritja e kreditimit për sektorin e prodhimit dhe bujqësisë në Kosovë reflekton gatishmërinë dhe interesin e bizneseve për të investuar dhe zgjeruar biznesin përbrenda Kosovës, që ndikon pozitivisht në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës dhe mbështet një normë të qëndrueshme të rritjes ekonomike", ka thënë Balija.

Gashi: Telekomit dhe 'Z-Mobile' të merren vesh për 220 000 numrat që janë në përdorim

Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, në raportimin para anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, ka thënë se për 220 000 klientët e "Z-Mobile"-s pas shkëputjes së kontratës duhet të ketë vijimësi të shërbimeve me operatorë të rrethit



EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, është intervistuar të hënën nga anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala. Gashi ka kërkuar që intervistimi i tij të bëhet pa praninë e medieve. "Jo që kemi diçka konfidenciale, por që ende nuk është marrë ndonjë vendim. Dhe në këtë drejtim mendoj se deklarimet tona mund të keqpërdoren në dëm të Telekomit të Kosovës. Kërkoj seancë të mbyllur dhe ju siguroj se nuk ka asgjë për të fshehur", ka thënë Gashi.

Anëtarët e këtij komisioni kanë kundërshtuar që ky intervistim të bëhet i mbyllur pasi, sipas tyre, nuk ka diçka për të fshehur.

Gjatë intervistimit kryetari i komisionit, Visar Ymeri, e ka pyetur Gashin se cilët do të jenë hapat që do të ndërmerren në vazhdim nga ARKEP-i pas shkëputjes së kontratës së Telekomit me "Z-Mobile". Sipas Gashit, për 220 000 klientët e "Z-Mobile"-s pas shkëputjes së kontratës duhet të ketë vijimësi të shërbimeve me operatorë të rrethit. "ARKEP-i nuk ka pasur mundësi të ndërhyjë paraprakisht, rregullatori nuk ka ndërhyrë deri më 30 korrik. Jemi informuar që ekziston faza e tranzicionit për klientët që kanë qenë deri atëherë të "Z-Mobile". Aktualisht titullar i klientëve është 'Z-Mobile', sepse ka kontratë, por kjo nuk e imponon gjithsesi bashkëpunimin në mes të këtyre dy kompanive, por nuk duhet bërë gabime", ka thënë ai. Sa i përket kërkesës së Telekomit për kthimin e 300 000 numrave që aktualisht ka "Z-Mobile",

Gashi ka kërkuar të respektohet Ligji për komunikime elektronike. "Ligji mund ta parashohë edhe kthimin e numrave. Ne jemi në një situatë unike", ka deklaruar ai. Gashi ka thënë se është kohë fushate, duke aluduar në atë se po bëhet fushatë për shpëtimin e Telekomit. Derisa Gashi ka përsëritur se këto deklarime mund të ndikojnë në proces, sipas anëtarit të komisionit, Armend Zemaj, ai mund të jetë i shantazhuar nga dikush. Sipas Zemajt, në bazë të asaj që thotë Gashi, "Z-Mobile" vazhdon të jetë pronar i klientelës edhe pas përfundimit të kontratës.

Por, Gashi ka thënë se shërbimet nuk mund të ofrohen nga dikush që nuk ka shërbim. "Telekomi nuk ka aplikuar ende për atë memoracion. Do të kërkojmë ndihmë edhe prej operatorëve në botë. Nuk do të ketë zgjidhje magjike", u shpreh ai.

Deputeti Bekim Haxhiu ka kërkuar të dijë se sa zyrtarë të ARKEP-it i kanë familjarët e tyre të punësuar në "Z-Mobile" dhe se nëse është e vërtetë se shefi për komunikime elektronike në ARKEP është i punësuar.


Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në ARKEP, Kreshnik Gashi, ka deklaruar se nuk e di nëse ka

konflikt të interesit dhe, po ashtu, ka pohuar se nuk është në dijeni se sa zyrtarë punojnë në "Z-Mobile". "Nuk mund të marrim vendime në mënyrë arbitrare. Unë nuk e di sa zyrtarë punojnë. Nuk di që ka konflikt interesi. Personalisht nuk e kam askënd të punësuar dhe nuk më takon mua të flas për familjarët e tjerëve", është shprehur Gashi. Ndërsa deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje!, Albulena Haxhiu, ka thënë se dyshon që shefi i ARKEP-it është duke punuar në favor të "Z-Mobile"-s, por një gjë të tillë e ka mohuar Kreshnik Gashi.

Kryeshefi i Telekomit i entuziazmuar që rrjeti mobil i 'Valës' mbetet operatori më i pëlqyer nga vizitorët

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar të hënën se është i entuziazmuar që rrjeti mobil i "Valës" mbetet operatori më i pëlqyer për vizitorët (InBound Roamers). "Në këtë moment në rrjetin tonë mobil janë të evidentuar mbi 156 mijë përdorues/numra që kanë përzgjedhur 'Valë'-n si partnerin më të besueshëm për komunikim. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar dhe vitet e tjera paraprake, rezultoni se kemi dyfishin e këtyre vizitorëve që janë të lokalizuar nëpër vendbanime të ndryshme të Kosovës, duke qenë të lidhur me rrjetin mobil të 'Valës'", ka shkruar ai. Istrefi ka thënë se kualiteti i shërbimeve dhe shpejtësia e internetit 4G/LTE janë përcak-

tues në përzgjedhjen e 'Valë'-s të të gjithë atyre, qoftë bashkatdhetarëve apo vizitorëve të huaj që gjatë këtyre muajve të verës ndodhen në vendin tonë. "Siç mund të vërehet edhe në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm, duke krahasuar periudhën e njëjtë nëpër vite të ndryshme, përkatësisht katër vjetët e fundit, 'Vala' ka shënuar rekord sa iu përket vizitorëve në rrjetin e saj. Kjo performancë e rrjetit tonë mobil dhe ky përkushtim i stafit të Telekomit të Kosovës më inkurajojnë se jemi në rrugën e duhur për t'i arritur objektivat dhe strategjinë e përcaktuar nga menaxhmenti dhe bordi që kompania jonë të vazhdojë të jetë lidere në tregun e telekomunikimit në vend", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (11) ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Njeriut që tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare, simbolit të rezistencës kombëtare, ideatorit të UÇK-së. Lavdi për jetë e mot, jetës dhe veprës heroike, Bacës, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Kamer Raci

Faleminderit Baca Adem që shumë dhe gjatë ke vuajtur për të gjithë ne dhe për mua gjithashtu... Të jam mirënjohës gjithë jetën!

Me veprime inteligjente dhe pa asnjë fije dyshimi dhe me zemër trimi ti ishe për të gjithë njerëzit e këtyre trojeve vetë frymëzimi... sa vet mohues që ke qenë... i madhi Ynë, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Bacë, bashkë me Ty e fituam lirinë! Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës, për të cilën dhe aq shumë!

27 korrik 2018,
Nerimanja

Lavdi të qoftë për jetë e mot, Bacë!

27 korrik 2018,
Lemane Kamberi

Ndihem e përmbushur kombëtarisht dhe familjarisht që u linda dhe u rrita në Epokën Tuaj, Baca Adem! Krenari që i takoj kombit që Ti aq shumë e deshe, dhe kjo dashuri, do të më përcjellë deri në frymën e fundit!
Lavdi o prijatar i rrugës së dritës për vendin dhe kombin tonë!

27 korrik 2018,
Ganimete Hasanmetaj-Abazi

Baca Adem,
Edhe pse vuajte shumë nëpër burgjet serbo-sllave, Ti ishe gjithmonë i këndshëm e buzagaz!
Mbetë stoik, me moral të pathyeshëm dhe shumë inspirues për kombin shqiptar dhe Kosovën tënde që aq shumë e deshe!

27 korrik 2018,
Qazim Fazlija

Bacë, Adem Demaçi,
Respekt deri në pakufi!
Faleminderit për gjithçka që kë dhënë për atdhe!

27 korrik 2018,
Arsim Sejdiu

Baca Adem,
Ishe, je dhe mbete Ikonë e atd-hedashurisë, patriot, Hero i të gjitha kohërave, për liri dhe pavarësi kombëtare shqiptare!

27 korrik 2018,
Xhemshir Haziri

Mbetem pa njeriun tonë të dashur, më madhështorin!
Kujtimi për Bacën Adem nuk do të vyshket kurrë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi përjetë Bacës, Adem, sa të ekzistoj njerëzimi!

27 korrik 2018,
Faik Latifi

Lavdi e përjetshme, Heroi Ynë, Baca, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Me respektin më të lartë njerëzor, i nderuari Baca, Adem!

27 korrik 2018,
Nazmi Nuha, Ferizaj

Me shumë respekt, Nderi i Kombit!

27 korrik 2018,
Ali Koni, Budakovë

Lavdi jetës dhe veprës për lajmëtarin e lirisë, Bacë Ademin e Madh - Demaçi!

27 korrik 2018,
SH. H. Feniks - Ferizaj

Më 28 nëntor 2018, iu dha lamtumira e fundit z. Adem Demaçi, shkrimtar, poet, ish i burgosur politik, veprimtar shoqëror, politikan i matur, mbrojtës i fjalës së lirë, mbrojtës i pakicave kombëtare, zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, frymëzues i paepur për liri, arsim, edukim dhe përparim kulturor e shpirtëror të popullit të Kosovës dhe më gjerë.

28 korrik 2018,
Bardhyl Selimi, Tiranë

Bacë, të dhamë Lamtumirën e fundit pa t'u plotësuar kauza e shenjtë!
Ne bashkëveprimtarët tuaj po

vazhdojmë të punojmë për të realizuar aspiratat tuaja dhe të popullit të Kosovës deri në kurorëzimin e bashkimit kombëtar.

Lamtumirë i deri në amshim,
baca Adem Demaçi!

28 korrik 2018,
Ilmi Ramadani

Shumë i dashuri dhe lart i respektuari, Ideali ynë Baca Adem, jam krenar që të kam pasur gjithmonë pishtar të Kombit dhe Atdheut. Populli shqiptar do të jetë përjetësisht krenar me Ty!

28 korrik 2018,
Enver Rama

Shumi i dashuri, Ti ke qenë ideali im!
Thank You, yours Trully!

28 korrik 2018,
R. Zeneli, Toronto, Kanada

Shenjtëri është për shokë, bashkëveprimtar, bashkë-atdhetar që i qëndruan pranë e pranë Bacës!

28 korrik 2018,
Behram Hoti, Ruzhdi Zeneli, Kanadë

I përjetshëm e i paharruar qofsh



Bacë!

28 korrik 2018,
Neon e Besar Hasanmetaj

Nën hijen tënde e gjejmë freskinë!

28 korrik 2018,
A. Hasanmetaj

Ishte nder i veçantë edhe për mua, të jem bashkëkohnik, ose i inspiruar nga Baca Adem! I përjetshëm qoftë kujtimi për Ju, brez pas brezi, Baca Adem Demaçi!

28 korrik 2018,
Emin Sallahu

Baca Adem ishte lokomotivë për

organizimin e gjeneratave që luftuan për lirinë kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

28 korrik 2018,
Hasan Abazi

Nuk do të harrohesh për jetë, Bacë!

28 korrik 2018,
Ragip (mbiemri i palexueshëm)

Bacë, aq ishe i madh, sa edhe ata që nuk të deshën të të thërrisnin, Bacë!

28 korrik 2018,
Aziz Pacolli

Për të madhërishtin HERO gjithëkombëtar, Bacën Adem! Lavdi!

28 korrik 2018,
Ukë Thaçi

Baca Adem, çdo herë më shumë po më përsëritet mendimi juaj: "mos t'i qesim vetit gardh, sepse vështirë të kalohet"!

28 korrik 2018,
Naim Bujupi

Ti ishe dritë shprese për gjithë popullin shqiptar!

28 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)


Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, i Madhi, Baca, Adem!

28 korrik 2018,
B. Kastrati

Baca Adem, nuk do të harrojmë kurrë se na mësove shumë! Edhe djemtë e mijë vdiqën me mësimin tënd. Nuk mund ta harroj edhe daljen e juaj prej burgut, se në atë kohë më lindi Astriti! Po, edhe ditëlindjen e keni të njëjtë! I lehtë ju qoftë dheu i Kosovës!
28 korrik 2018,
Xhemile Dehari

Jemi këtu një pjesë e vogël e fshatit Carrallukë të Malishevës, për t'u ndarë nga njeriu ynë i madh, i cili me shembullin e jetës dhe me veprën e tij na dha shpresë e besim, na bëri që të ndihemi më të fortë! Jemi këtu për t'i thënë shumë herë faleminderit dhe Lavdi Bacës Adem Demaçi!

28 korrik 2018,
Gani Krasniqi, në emër të fshatit Carrallukë



Faksimil i përshtypjes të Meriman Brahës,
bashkëveprimtar i Adem Demaçit

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Në tri ditët e fundit, asnjë rast i thumbuar nga rriqrat në Malishevë

MALISHEVË, 5 GUSHT (ER) - Në tri ditët e fundit nuk është regjistruar asnjë rast i thumbimit nga rriqrat në territorin e Komunës së Malishevës. Kështu është thënë gjatë raportimit në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e cila është drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive komunale

kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim.

Sipas drejtorit komunal për Shëndetësi, Liridon Hoti, gjatë këtij viti asnjë rast nuk është regjistruar me infeksion nga ethet hemorragjike, kurse në tri ditët e fundit nuk është regjistruar asnjë rast i thumbit nga rriqrat, që do të thotë se është zvogëluar rreziku por,

pavarësisht kësaj, gatishmëria e shërbimeve në raport me EHKK do të jetë sikur ditët e para dhe kujdesi do të jetë i vazhdueshëm.

Në mbledhjen e sotme, bazuar në raportet e drejtorive komunale, u deklarua se janë duke u realizuar shumë projekte në terren, ndërsa gjatë javës në vijim do të fillojnë së realizuari edhe disa projekte të tjera. Po ashtu, sipas drejtorisë së

arsimit janë duke u bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, e në kuadër të përgatitjeve është në përfundim e sipër renovimi i objekteve shkollore dhe deri në shtator pritet që të gjitha shkollat të jenë të gatshme, përfshirë edhe dy objektet e reja shkollore që priten të hapen për herë të parë. Sa i përket mjedisit, sipas inspektoratit komunal, janë



shqiptuar disa gjoba mandatore për ndotje të mjedisit, por duhet të rritet angazhimi nga ana e organeve përgjegjëse për mbrojtje dhe pastrim të ambientit, sidomos në këtë pjesë të vitit, në veçanti në qytet.

Hapet panairi i produkteve bujqësore në Ferizaj

FERIZAJ, 5 GUSHT (ER) - Sheshi qendror i Ferizajt të hënën është 'vërshuar' nga qindra produkte të sjella për ekspozim nga bujqit dhe fermerët ferizajas. Bujqit në këtë shesh ngrehën standat e tyre të ardhur nga fshatra dhe zona të tjera të Ferizajt dhe më gjerë në hapje të panairit të produkteve bujqësore që po organizohet për herë të dytë si rrjedhojë e bashkëpunimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe organizatës IKC.

Për të bashkëbiseduar me bujqit, fermerët si dhe për t'i parë e blerë produktet e tyre doli edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu. Investimet në mekanizëm bujqësor, ndihmesa me produkte dhe pajisje dhe subvencionime të tjera ishte theksi që vuri i pari i Ferizajt në fjalën e tij.

Më tutje, ai u zotua se do të vazhdojë dhe rritet mbështetja për bujqit ferizajas. "Dëshirojmë t'ju mbështesim, sepse duhet jetuar nga puna dhe ne e çmohim punën tuaj dhe dëshirojmë të jemi pjesë e kësaj pune të ndershme. Dëshirojmë të jemi pjesë e mbështetjes së njerëzve që e zhvillojnë ekonominë por, mbi të gjitha, me produktet tuaja sigurohet edhe shëndeti i qytetarëve, pasi nuk ka më mirë dhe më sigurt se të konsumosh prodhime vendore", ka thënë Aliu.

Përfaqësuesi i IKC-së, Agron Arifi, duke falënderuar Komunën e Ferizajt për mbështetjen e pakursyer për organizimin e këtij panairi, ka thënë se ky organizim është një mundësi për rritjen e shitjes së produkteve vendore.



Më 10 dhe 11 tetor në Universitetin e Mitrovicës mbahet konferenca Multidisiplinare në Gjeoshkencë



MITROVICË, 5 GUSHT (ER) - "Konferenca Ndërkombëtare Multidisiplinare në Gjeoshkencë", e cila do të mbahet në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" më 10 dhe 11 tetor, ka zgjuar interesim të shkencëtarët nga shumë vende të botës. Kjo u tha në takimin e Këshillit Organizativ (Fakulteti i Gjeoshkencave, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës), ku ishte i pranishëm edhe rektori i UMIB-it, Alush Musaj. Sipas organiza-

torëve deri më 20 korrik, kur është mbyllur afati, për pjesëmarrje në konferencë janë regjistruar 86 pjesëmarrës. Gjithashtu, është bërë me dije se janë dorëzuar gjithsej 55 abstrakte, prej të cilave janë pranuar 42 sosh. Përveç studiuesve nga universitetet vendore, në konferencë do të marrin pjesë edhe studiues dhe shkencëtarë nga vende të ndryshme të botës si nga Finlanda, Italia, Polonia, Turqia dhe Sllovenia. Studiuesit që vijnë nga jashtë janë kryesisht profesorë në universitetet me të cilat Fakulteti i Gjeoshkencave ka

bashkëpunim.

Rektori Alush Musaj ka përgëzuar organizatorët për punën që po bëjnë. Ai ka thënë se një konferencë e tillë ndikon në rritjen e interesimit të studentëve për punë shkencore si dhe në prestigjin e universitetit. Musaj ka premtuar mbështetje për të gjitha fazat e konferencës. Në takimin e Këshillit Organizativ u vendos për ftesat që duhet të dërgohen për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, të cilat do ta kenë rastin dhe mundësinë që t'i shpalosin të arriturat e tyre etj.

Rriten të hyrat në Komunën e Rahovecit

Rahovec, 5 gusht (ER) - Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit është e angazhuar për rritjen e të hyrave komunale. Nga ky angazhim kjo drejtori ka arritur të mbledhë në periudhën janar-qershor të vitit 2019 608 272 euro, ndërsa

në të njëjtën periudhë të vitit 2018 ishin realizuar 517 226 euro. Komuna e Rahovecit ka arritur që të realizojë 51 përqind të të hyrave nga buxheti i planifikuar për këtë vit, kur dihet se kanë mbetur edhe gjashtë muaj të tjerë deri të përfundimi i vitit fiskal.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Afrim Limani, ka thënë se këto të hyra realizohen nga taksat komunale dhe të hyrat tatimore, siç është tatimi në pronë e taksat e tjera. Sipas tij, vetëm nga të hyrat nga tatimi në pronë janë realizuar 244 490 euro. "Kjo peri-

udhë njihet si periudha më e mirë e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë. Kjo rritje e të hyrave në komunën tonë është rezultat i përkushtimit të qeverisë komunale, e kryetarit dhe të gjithë drejtorëve dhe stafit të Drejtorisë së Financave", ka thënë drejtori



Limani. Po ashtu, ky rezultat i arritur është edhe falë tatimpaguesve të cilët kryejnë obligimet e tyre me kohë.

Fjalë rasti në ceremoninë e varrimit të mërgimtarit Abaz Berisha

IKU ME ËNDRRËN E PAREALIZUAR PËR KTHIM NË VENDLINDJE

Zeqir BEKOLLI

Dje i thamë lamtumirën e fundit vëllait, prindit, bashkatdhetarit dhe birin tonë të shtrenjtë, njërit prej mërgimtarëve të viteve të nëntëdhjeta, Abaz Berishës, i cili në moshën 62-vjeçare ndërroi jetë në Gjermani, pas një sëmundje të rëndë. Vdekja e tij e hershme na preku thellë. Ai u nda prej nesh me ëndrrën e porealizuar për kthim në vendlindje, ëndërr me të cilën sot bashkëjetojnë mërgimtarët tanë anekënd botës.

Abazi i përket familjes Berisha, e njohur për atdhetari në Drenicë. Babai, Beqiri, ishte pjesëmarrës i luftës së Drenicës, që e udhëhoqi komandanti Shaban Palluzha dhe luftëtar i aradheve ushtarake të Shqipërisë. Si personalitet që ishte, në familjen e vet ai kultivoi frymën atdhetare nga e cila u frymëzua mbarë familja. I njohur për guximin dhe qëndrimin e tij, Baca Beqir, në periudhën pas viteve '60, kur në Kosovë

që përhapur ideja për Kosovën Republikë, në një mbledhje të fshatit Vasilevë, para pjesëmarrësve kërkoi haptas formimin e Republikës së Kosovës. Ky fakt dëshmon se familja Berisha që herët ishte e përcaktuar për rrugën e çlirimit të Kosovës. Këtë rrugë të trashëguar nga babai i tyre e ndoqën edhe bijtë e tij.

Abazi, pas përfundimit të shkollës së mesme, një periudhë të gjatë kohore kishte punuar në organizatën punuese "Drenica" në Drenas, ku ishte treguar punëtor i zellshëm dhe i respektuar në mesin e kolektivit.

Kur lufta shpërtheu në Kosovë, vëllezërit e Abazit, Ajvazi dhe Qaushi, pa hezitur u bënë pjesë përbërëse e luftës. Edhe Abazi ishte tejet këmbëngulës që t'u bashkohej atyre në luftë, por atë e kishte sugjeruar i vëllai, Ajvazi, të qëndronte në Gjermani dhe prej atje ta ndihmonte luftën dhe familjen. Mbi këtë sugjerim, Abazi në mërgim zhvilloi një aktivitet të ngjeshur në mbështetje të luftës dhe rrjed-

have të saj. Ai, pos mjeteve vetjake që i dha për luftën, ishte ndër koordinatorët më të suksesshëm të mbledhjes së mjeteve për fondin "Vendlindja thërret". Këtë punë e bënte me një dëshirë dhe vullnet të madh. Falë angazhimit dhe autoritetit, që kishte në mesin e mërgimtarëve, Abazi arriti të sigurojë mjete për luftën dhe nevojat e popullsisë në Kosovë e cila aso kohe gjendej para rrezikut për shfarosje kolektive. Ai vlerësohej shumë në mesin e mërgimtarëve të cilët e donin, e respektonin dhe në këtë drejtim edhe e përkrahnin.

Ne u ndamë nga Abazi ynë i dashur, por shëmbëlltyra dhe kontributi i tij na bënë krenarë që e patëm këtë vëlla, prind, bashkëkombës dhe mik të tillë. Duke i kujtuar veprat e tij të mira në shërbim të atdheut, do ta kemi më lehtë ta përballojmë edhe dhembjen, që këto ditë na rëndon me rastin e largimit të tij të hershëm nga mesi ynë. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës të cilën e desh shumë!



JO ZGJEDHJE ME ANALFABETË FUNKSIONALË, ZGJOHUNI PËR KOSOVËN!



Astrit GASHI

Premtime marramendëse, fjalime boshe, shpenzime koti e çka jo tjetër do të dëgjojmë përditë këto ditë vere në disa medie tona të cilat janë rreshtuar në krah me këta analfabetë funksionalë të cilave nuk u dihet burimi se nga paguhen për këtë servilizëm ndaj padronëve të tyre të cilët vetëm për Kosovën nuk punojnë.

Në anën tjetër, njerëz që zihen për padronët e tyre, se kush e cili do të triumfojë në këto zgjedhje të cilat nuk dihet të kujt janë?!

Dikush do të thoshte, shumë mirë, kjo është shenjë e qytetarisë aktive në Kosovë. Për

mua, kjo është krejt diçka tjetër. Në mungesë të mundësive për të gjetur një vend pune, që vjen si pasojë e nepotizmit, korrupsionit e pazarllëqeve të tjera të të ashtuquajturve politikëbërës, këta të rinj detyrohen të rreshtohen pranë 'padronëve' të tyre.

Është dëshpëruese t'i shohësh, të sapodalë nga fakultetet, në vend se të orientohen për të punuar dhe specializuar në fushat e tyre, me çka do t'i kontribuonin vetes së tyre dhe mbarë vendit, këta të rinj vendosin të rreshtohen krah përkrah me 'padronët' e ardhmërisë së tyre. Është e dhimbshme, sepse vetëm po t'u shohësh postimet e tyre në platformat sociale, të mbushura me gabime gjuhësore dhe të paformuluara, kuptohet se në çfarë 'drexhe' i ka sjellë sistemi edukativo-arsimor në Kosovë, i cili është nën përkujdesjen e mu këtyre 'padronëve' të cilët i kanë nga pesë-gjashtë diploma ani pse nuk dinë shkrim lexim!

Është për të ardhur keq se si pranojnë të rreshtohen krah përkrah atyre që i sollën në këtë gjendje sa të mos dinë se ku duhet të rreshtohen! Është jo vetëm e dhimbshme, por dhe e dëmshme për ardhmërinë e tyre e, mbi të gjitha, të vendit, kur i sheh tek pozojnë pranë me ato buzëqeshjet cinike pranë këtyre njerëzve të cilët për një votë japin gjithçka është e mundur vetëm që të jenë në pushtet për ta vjedhur ketë shtet i cili asnjëherë nuk u ngrë në këmbë nga armiku i brendshëm i cili na ka dërguar buzë humnerës.

Është tragjike t'i shohësh këta të rinj gjersa i dorëzojnë 'dëshirat, ambicinet dhe energjinë' e tyre nën përkujdesjen e atyre që deri më tani iu mbyllën dëshirat, iu mbyllën rrugët dhe po ua mbyllin motivin për t'u zhvilluar e jetuar si 'njeri'. Mbi të gjitha, i bënë 'analfabetë funksionalë', ndryshe s'kam si e shpjegoj vendimin e tyre për t'u rreshtuar me ata që gjysmën e

fushatës duhet ta kalojnë në gjykatë e pjesën tjetër të çirren si të marrë për t'i mbledhur votat në emër të patriotizmit e të gjitha bizneset e tyre të dërgojnë në veri të vendit.

Votimi është shumë i rëndësishëm për të ardhmen tënde, por dhe timen. Por, përmbi votimin më e rëndësishmja është të dish ta zgjedhësh 'padronin' tënd! Për të zgjedhur duhet të jesh i përgatitur, i mirinformuar e, mbi të gjitha, i ditur. Dituria është fuqi dhe nëse nuk mëson se si ta përdorësh 'zërin tënd' kur vjen momenti për të vendosur, atëherë zëri yt nuk do të dëgjohej. Këto grupe klanore në të gjitha partitë politike kanë interesin e vetëm se si për të ardhur në pushtet dhe jo se si për të ndërtuar një jetë më të mirë për qytetarët.

Sot disa komandantë të cilët nuk morën pjesë në asnjë betejë po mendojnë të formojnë dinasti në rrethet e tyre, ndërsa disa të tjerë po mendojnë se

mund të fitojnë vota edhe me persona të cilët me vite kanë ikur nga kjo botë.

Disa bashkëpunëtorë të regjimit sot po mendojnë se populli i ka harruar shërbimet e tyre për pushtuesit. Sot populli është bindur se ju jeni me popullin vetëm atëherë kur ju duhet vota e tij.

Presidenti amerikan Theodor Roosvelt e ka shpjeguar shumë mirë rëndësinë e votës "Vota është si pushka, dobia e saj varet nga karakteri i përdoruesit". Nëse sot e ke shitur votën tënde për këta "analfabetë funksionalë" ti nesër e shtet kombin, andaj sot duhet me vendos - t'i themi jo territ, jo diplomave të natës, jo okupimit vendor e ndërkombëtar të zgjohemi nga gjumi të vendosim vetë për lagjen tonë, për rrethin tonë dhe për vendin tonë. Jo zgjedhje pa reforma, por qeveri teknike! Këtë që kjo klasë politike i ka bërë Kosovës nuk mund t'i bëjnë as pushtuesit me shekuj.

Calvin Harris mbush 'Instagram'-in me shqiptarë



DJ me famë ndërkombëtare, Calvin Harris, të dielën në mbrëmje ka argëtuar mijëra njerëz në festivalin Sunny Hill në parkun e Gërmisë. DJ i njohur erdhi për herë të parë në Prishtinë dhe ai u përkujdes që performancat e tij të mbeten gjatë në kujtesën e shqiptarëve. Ajo që ra në sy të hënën ishte

"Instagram"-i i tij, saktësisht "instastory" ku dominojnë shqiptarë. DJ zgjodhi disa prej njerëzve të cilët e kishin etiketuar atë mbrëmje dhe i hodhi në "instastory", aty ku ka miliona ndjekës. Festivali Sunny Hill u mbyll të dielën pas tri netëve elektrizuese me artistë ndërkombëtarë e shqiptarë.

Aaron Carter ndahet nga e dashura



Këngëtari 31-vjeçar dhe artistja 28-vjeçare konfirmohet se kanë prishur marrëdhënien e tyre, raporton "Page Six". "Unë dhe Lina kemi vendosur të ndahemi. Unë me të vërtetë shpresoja se kjo do të ishte ajo që zgjat përgjithmonë. Ne madje kishim biseduar edhe për të pasur fëmijë, por marrëdhënia përfundimisht u bë e pashëndetshme.

Kam kaluar kaq shumë jetë dhe jam duke u përpjekur të mësoj nga gabimet e mia. Unë mendoj se ky vendim ishte gjithë e pjekur për të bërë. Do të vazhdoj të përqendrohem në muzikën time, turneun tim dhe fansat e mi. Shpresojmë që shpirtin tim binjak do ta takoj së shpejti", ka thënë Aaron në një deklaratë.




Britney Spears në Disneyland me djemtë

Djemtë e Britney Spearsit janë rritur tashmë. Këngëtarja 37-vjeçare kaloi të dielën me djemtë e saj Sean, 13-vjeçar dhe Jayden 12-vjeçar, në Disneyland. "Kohë e mrekul-

lueshme sot në Disneyland", ka shkruar Britney nën një fotografi të postuar në rrjetet sociale. Javën e kaluar djemtë e saj panë nga afër një lojë bejsbolli bashkë me tezen e tyre Jamie Lynn Spears.

Barbara Palvin me urim të veçantë për ditëlindjen e të dashurit

Barbara Palvin ia ka shprehur dashurinë të dashurit të saj Dylan Sprouse në ditëlindjen e tij. Modeluesja 25-vjeçare përmes rrjetit social "Instagram" ka uruar në mënyrën më të mirë të dashurin e saj pasi mbushi 27 vjet. "Gëzuar ditëlindjen! Faleminderit që më le të jem pjesë e jetës tënde! Jam shumë krenare për njeriun e zellshëm që je dhe shpresoj që ky vit të të mbushë me dashuri dhe lumturi të cilën e meriton. Të dua", ka shkruar Barbara në një fotografi të përbashkët me Dylan Sprouse.



E jashtëzakonshme


Mbi 12 miliardë ton akull janë shkrirë vetëm brenda një dite në Grenlandë

Brenda vetëm një dite në Grenlandë janë shkrirë 12 miliardë ton akull si pasojë e të nxehtëtit të lartë në atë region. Me ngjyrë gri janë krijuar lumenj nëpër akullnaja derisa në shumë pjesë shihet edhe sipërfaqja tokësore. Sipas "CNN"-së, sasia e akullit që është shkrirë është sa katër miliardë pishinë olimpikë, ndërsa të



shkrirrit po vazhdon me intensitet pak më të ulët. Njohësit e ambientit kanë bërë të ditur se shkaku i nxehtësisë së gushtit të këtij viti do të shkrihen rreth 197 miliardë akull që ndodhen nëpër dete të ndryshme.

FOTO E DITES



Pelegrinët myslimanë shihen rreth Qabesë, në qytetin e shenjtë mysliman të Mekës, Arabinë Saudite. /AP/

E rrallë

Ky është sandviçi më i veçantë që keni parë ndonjëherë

Restoranti i quajtur Elsie's, i cili gjendet në New Jersey, është vetëshpallur si "shtëpi e sandviçit turshi", pasi çdo sandviç që përgatitet aty në vend të bukës si përbërës ka tranguj. Aty mundeni të porositni sandviçe nga të gjitha llojet dhe format, duke filluar nga të mëdhenjtë dhe duke vazhduar



te flegrat e holla të mbushura me mish. Sipas "DiplyFacts", pronarja e restorantit Katherine Cohen ka thënë se ata kanë ringjallur një recetë të vjetër të turshive familjare për ta ndarë këtë përvojë me klientët e tyre.

BARSOLETA E DITËS



Në Gjakovë e vet djali babën:

- Djali: Babë, qysh janë shanset, a do të shkojmë këtë vit në deti?

- Baba: 40 për qind shkojmë, a 100 për qind nuk shkojmë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse jeni të angazhuar në një biznes familjar sot do t'ju duhet të zgjidhni gjithçka vetë, edhe drejtimin dhe punët që ju kanë dalë.</p>	 <p>DEMI Sot do të doni të harroni një zhgënjim zemre dhe do të krijoni situata dhe çaste që do t'ju heqin mendjen.</p>	 <p>BINJAKËT Një situatë e papritur do t'ju turbulojë ditën sot. Në gjithë këtë kaos idesh jeni të sigurt vetëm për një gjë, mbështetjen e partnerit.</p>	 <p>GAFORRJA Keni siguri në punën që bëni dhe nëse do t'ju jepnin një ofertë edhe më të mirë financiare nuk do ta ndërronit. Kjo gjë sot do të dalë në një bisedë mes miqsh.</p>	 <p>LUANI Ditë e përkryer për të nisur një udhëtim dhe idenë e vendit do ta ofroni ju. Me miqtë ose me familjen sot do të shijoni çdo çast të ditës.</p>	 <p>VIJGJËRËSHA Me kalimin e orëve nuk do ta kuptoni as vetë se kush ishte qëllimi fillestar që jeni përfshirë në një situatë tensioni. Do të mundoheni të dilni sa më shpejt.</p>
 <p>PESHORJA Jeni tip i drejtë dhe korrekt dhe këtë gjë do të pretendoni edhe nga personat e tjerë. Në shumë raste nuk mund t'i zgjidhni njerëzit me të cilët bashkëpunoni.</p>	 <p>AKREPI Sot do të jeni mjaft flirtues dhe argëtues në të njëjtën kohë. Në çdo çast do të shijoni atë që ju ofrohet sa më këndshëm.</p>	 <p>SHIGJETARI Keni debate në lidhjen tuaj sentimentale dhe nuk mund ta kaloni këtë ditë të qetë sepse gjithçka do të reflektojë në fushat e tjera të jetës.</p>	 <p>BRICJAPI Ditë mjaft e ngarkuar në punë sepse gjithçka po mundohen t'ju kalojnë juve. Një ngërc me kolegët do të bëjë të zgjidhni edhe punë që s'ju takojnë.</p>	 <p>UJORI Gjithçka shkon mirë në ditën tuaj dhe ju ndiheni në qiellin e shtatë. Një ndryshim rrenjësor që ju tremb do të dalë shumë për mirë.</p>	 <p>PESHQIT Nëse jeni duke trajtuar kontrata të ndryshme do të arrini të finalizoni më të mirën nga opsionet. Do të keni marrëveshje mjaft frytdhënëse.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Abazi: Vendosa për Prishtinën sepse është klubi më i madh në Kosovë

Prishtina e prezantoi të hënën futbollistin Leonit Abazi, kurse zyrtarizoi edhe dy largime Argjend Mustafën dhe Bleon Sekiraqën. Abazi pas prezantimit si futbollist "bardheklatër" ka deklaruar: "Vendosa për Prishtinën sepse është klubi më i madh në Kosovë, klubi më i trofeshëm dhe me ambicie shumë të mëdha"



"Epoka e re"

PRISHTINË, 5 GUSHT - Skuadra e Prishtinës ka bërë një transferim jashtëzakonisht të madh të hënën, pasi nga futbollit i Shqipërisë e ka rikthyer sërish në futbollin e Kosovës Leonit Abazin. 26-vjeçari nga Gjilani në korrik të vitit 2013 kishte kaluar te Skënderbeu i Korçës, duke arritur të fitojë shumë trofe dhe më pas luajti edhe në grupet e Evropa Ligës. Futbollisti gjilanas ka zhvilluar me skuadrën shqiptare plot 123 ndeshje dhe ka shënuar 6 gola. Pas prezantimit si lojtar i Prishtinës, Abazi ka folur për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas, duke thënë se e ka pranuar ofertën e kësaj skuadre, pasi është më e madhja në Kosovë. "Vendosa për Prishtinën, sepse është klubi më i madh në

Kosovë, klubi më i trofeshëm dhe me ambicie shumë të mëdha dhe kjo ishte arsyeja më e madhe e kësaj zgjedhje. Sigurisht që pres titullin kampion me Prishtinën, aty ku e ka vendin klubi dhe të ecim sa më lart në Evropë. E njoh ekipin e Prishtinës, e kam përcjell edhe sa isha në Shqipëri sikurse edhe kryetrajinerin Josa të cilin e kam pasur trajner edhe te skuadra e Skënderbeut. Është trajner me përvojë dhe kam respekt të madh për të", ka thënë Abazi.

Skuadra e Prishtinës të hënën zyrtarizoi edhe shkëputjen e marrëveshjes me mesfushorin Argjend Mustafa. Kontrata e mesfushorit në fjalë ishte e vlefshme edhe për dy vjet, por ajo është ndërprerë me marrëveshje të dyanshme. Përveç Mustafës, nga skuadra e Prishtinës është larguar edhe Bleon Sekiraqa, i cili karrierën do të

vazhdojë në skuadrën e Ballkanit nga Suhareka. "Mustafa ishte transferuar edicionin e kaluar nga Trepça '89, kurse me skuadrën kryeqytetase ka regjistruar 29 paraqitje (10 zëvendësuar, 9 zëvendësues) duke asistuar në dy gola. Ndërsa Bleon Sekiraqës i ka skaduar kontrata dhe është futbollist i lirë. Sekiraqa është fëmijë i Shkollës së Futbollit, ndërsa me Prishtinën ka regjistruar 5 paraqitje si zëvendësues, ndërkohë e ka edhe një paraqitje në garat ndërkombëtare kundër Norkoping (0:1)", thuhet në njoftimin e skuadrës së Prishtinës.

Skuadra që drejtohet nga Mirel Josa edicionin e fundit dështoi në garën për titull, por edhe në Kupë. Ajo mori pjesë në Ligën e Evropës si nënkampione e Kosovës, derisa nuk arriti ndonjë rezultat për t'u veçuar, kurse në edicionin e ri 2019/2020 ka synim të shpallet kampion e Kosovës.

SHKURT

Milani sjell në Kosovë trofeun e Ligës së Kampionëve

Më 10 gusht do të zhvillohet miqësorja në mes të Feronikelit dhe skuadrës së famshme italiane, Milan. Klubi kampion i Kosovës ka njoftuar se kuqezinjët e Milanit do të marrin me vete në Kosovë trofeun e Ligës së Kampionëve. "Milani me vete do ta ketë edhe trofeun e famshëm të Ligës së Kampionëve, për ta shfaqur para të pranishmëve në stadium. Ndeshja fillon prej orës 20:45", thuhet në njoftimin e "Niklit". Biletat për këtë ndeshje kushtojnë nga 15 euro deri në 89 euro.

Tre lojtarë largohen nga Dukagjini

Mbrojtësi i krahut të majtë, Kadri Kastrati, është larguar nga skuadra e Dukagjinit dhe është transferuar në skuadrën e Istogut në Ligën e Parë. Ndërsa skuadra nga Klina e ka konfirmuar edhe largimin e Drin Lladrovci dhe Burim Qorrit. "Për disa vjet pjesë e klubit tonë, Kadria tashmë ka vendosur ta vazhdojë karrierën futbollistike në një klub tjetër. Gjithashtu, edhe dy futbollistët që ishin bashkuar në janar me Dukagjinin, Drin Lladrovci dhe Burim Qorri, nuk janë më pjesë e jona dhe ne iu urojmë suksese të tjera", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Davorin Nakiq në Kosovë për Evropianin e femrave

Kampionati Evropian i Divizionit B për femra U20 po vazhdon ndeshjet interesante. Në këtë Evropian do të ketë edhe disa mysafirë specialë, ku më 7 dhe 8 gusht do të qëndrojnë presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel. Por, do të ketë edhe disa mysafirë të tjerë specialë. Nga 7 deri më 10 gusht në Prishtinë do të qëndrojnë Davorin Nakiq, shefi i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA Evropës. Nakiq gjatë katër ditëve sa do të qëndrojë në Kosovë, do ta monitorojë Evropianin. Ai edhe më herët ka qenë në Kosovë, duke parë punën nga afër me gjyqtarët e basketbollit të Kosovës. Kjo është hera e parë që një Evropian i Divizionit B po organizohet në Prishtinë. Kampionati ka filluar më 3 gusht dhe do të zgjasë deri më 11 gusht.

Lamçja rikthehet në Kosovë, zgjedh Vushtrinë

VUSHTRRI, 5 GUSHT - Futbollisti nga Shqipëria, Eri Lamçja, është rikthyer sërish në futbollin e Kosovës, por ndryshe nga hera e parë, sulmuesi këtë herë vendosi për ofertën e

Vushtrrisë. "Sulmuesi 25-vjeçar, i lindur në Elbasan, pjesë e Akademisë së KF Elbasanit, duke vazhduar më pas me klubet e KF Teutës së Durrësit dhe KF Luftëtarit nga

Gjirokastra, ndërsa në edicionin 2018/19 është transferuar në ekipin e KF Dritës nga Gjilani, ku pas qëndrimit gjashtëmujor transferohet te skuadra e KF Bylis nga

Shqipëria", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vushtrrisë. Kjo e fundit në edicionin 2019/2020 do të bëjë gara në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.



Maguire: Nuk refuzohet oferta e Unitedit

MANCHESTER, 5 GUSHT - Mbrojtësi i Manchester Unitedit, Harry Maguire, është i lumtur që është bërë lojtar i ri i Manchester Unitedit. Gjatë prezantimit mbrojtësi anglez ka lënë të nënkuptohet se oferta nga një skuadër siç është Unitedi nuk refuzohet. "Jam i lumtur që kam nënshkruar

për këtë klub të shkëlqyeshëm. Unë e kam shijuar plotësisht kohën time në Leicester dhe do të doja t'i falënderoja të gjithë në klub, edhe tifozët për mbështetjen fantastike gjatë dy sezoneve të kaluara. Sidoqoftë, kur Manchester Unitedi vjen duke trokitur në derën tuaj, është një mundësi e

jashtëzakonshme. Nga bisedat e mia me menaxherin unë jam i ngazëllyer për vizionin dhe planet që ai ka për ekipin. Është e qartë që Solskjaer po ndërton një ekip për të fituar trofe. Tani po pres me padurim t'i takoj shokët e mi të rinj të skuadrës dhe të fillojë sezoni", ka thënë Maguire.



Muslija, gati për ndeshjet ndaj Çekisë dhe Anglisë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Anëtar i më i ri i Përfaqësueses së Kosovës, Florent Muslija, tashmë ka kryer të gjitha procedurat e nevojshme në Ambasadën e Kosovës në Gjermani dhe gjatë kësaj jave do të pajiset me pasaportë të Kosovës. Muslija do të jetë i gatshëm për ndeshjet e radhës që "Dardanët" do t'i luajnë në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2020. "Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, falënderon ambasadorin Beq Cufaj, stafin e Ambasadës, Ministrinë e Brendshme dhe të gjitha institucionet e tjera që në raste të këtilla kanë konsideratë dhe i përshpejtojnë procedurat për marrje të nënshtetësisë së Kosovës për futbollistët që veshin fanellën 'dardane'. Po ashtu, një falënderim i veçantë edhe për përfaqësuesin e Kosovës në Gjermani, Fekmi Kongjeli, i cili ishte iniciator i bisedimeve që Florenti t'i bashkohet Kosovës", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Florent



Muslija është pjesë e Hannover 96 dhe është lojtar shumë i talentuar, i cili pa dyshim do të jetë një armë më shumë për përzg-

jdhësin Bernard Challandes në misionin për ta bërë ëndrrën realitet - kualifikimin në "Euro 2020".

Berisha: Duam të bëjmë një kampionat të mirë

FERRARA, 5 GUSHT - Portieri shqiptar Etrit Berisha luan prej 6 sezonesh në Serinë A, me Lazio, Atalantën dhe këtë vit do të hyjë në sezonin e 7-të me Spalin. 30-vjeçari ka folur në një intervistë, pas ndeshjes kundër Hellas Veronës e mbyllur 0-0. "Kemi luajtur një ndeshje shumë të mirë, sidomos në mbrojtje. Jemi akoma në përgatitje dhe kemi shumë kohë për ta rikuperuar formën e duhur fizike. Duhet të punojmë akoma që të përmirësohemi më shumë. Do të jetë e vështirë për të arritur qëndrimin në Serinë A. Këtë sezon të gjitha skuadrat duan të bëjnë mirë, ato po përforcohen dhe në duhet të luftojmë fort. Duam të bëjmë një kampionat të mirë dhe të jemi protagonistë. Jemi gati për të filluar dhe kemi shumë besim për sezonin e ri. Këtu është shumë mirë, shokët e rinj më kanë ndihmuar për të arritur në formën e duhur. Jam shumë i lumtur



këtu", ka thënë Berisha. Kujtojmë se Berisha u transferua në Itali, nga skuadra suedeze Kalmar, për të qëndruar në 3

sezone tek Lazio ku zhvilloi 60 ndeshje, më pas 3 sezona të tjera me Atalantën ku zhvilloi 91 ndeshje.

SHKURT

Musliu nga Shkëndija transferohet në Fehervar

Shkëndija e Tetovës dhe MOL Fehervar FC kanë arritur marrëveshje për transferimin e mbrojtësit Visar Musliu në radhët e ish-kampionëve të Hungarisë. Hungarezët do të paguajnë në llogari të Shkëndijës një shumë të caktuar (mediet në Maqedoninë e Veriut shkruajnë për 500 mijë euro) për blerjen e kartonit të futbollistit një vit para skadimit të kontratës së tij me kuqezinjët. Visar Musliu largohet nga Shkëndija pas një viti e gjysmë, periudhë gjatë së cilës fitoi tre trofe me kuqezinjët, dy kampionate dhe një kupë. Ai zhvilloi 62 paraqitje zyrtare me fanellën e Shkëndijës (43 kampionale, 7 në Kupë dhe 12 në Evropë), duke shënuar 9 gola (6 në kampionat dhe 3 në Kupë).

Lëndohet Messi

Lionel Messi është lënduar dhe nuk do të paraqitet për Barcelonën në turneun parasezonal në ShBA. Barça ka njoftuar se lojtari është larguar nga stërvitjet për shkak të dhimbjeve në këmbën e djathtë. Pas testimeve është vënë re se ai ka pasur një zgjatje muskuli. Messi do të qëndrojë tani në Barcelonë, ndërsa kur do të rikthehet nuk është bërë me dije.

Mignolet largohet nga Liverpooi, vjen Adrian

Liverpooi e ka shitur Simon Mignolet për 7 milionë euro te Club Brugge, kurse menjëherë e ka zëvendësuar atë me portierin Adrian. Portieri 32-vjeçar u largua në fund të sezonit nga West Ham dhe "Reds" e merr si lojtar të lirë, duke mos paguar asnjë qindarkë për të. Në karrierën e tij ai ka luajtur vetëm me skuadrën e Real Betisit para se të transferohej në Premierë Ligë në vitin 2013.

Balotelli mund të transferohet në Brazil

Mario Balotelli e mbylli sezonin me Marseillen dhe tani është një lojtar i lirë. Parma, Brescia dhe Verona po tentojnë ta rikthejnë në Serinë A, por 29-vjeçari (i mbush më 12 gusht) mund të transferohet jashtë kontinentit evropian. Flamengo e kërkon dhe drejtuesit e klubit kanë nisur negociatat me Mino Raiolën. Problem mbetet vetëm rroga, por Flamengo është gati të bëjë një sakrificë ekonomike për sulmuesin e njohur. 2.5 vjet zgjat kontrata që i kanë propozuar brazilianët "Super Marios", i cili tundohet nga kjo ide.

Nainggolani rikthehet te Cagliari

Radja Nainggolan edhe zyrtarisht është larguar nga skuadra e Interit. Mesfushori belg i ka dhënë fund aventurës me Interin vetëm pas një viti qëndrim në "Giuseppe Meazza". Nainggolan i është bashkuar Cagliari si huazim nga Interi, por që klubi italian nuk e ka të drejtën e blerjes. "Jemi të lumtur t'ju njoftojmë se Radja Nainggolan është rikthyer në shtëpinë e vet. 'Ninja' dëgjoji zemrën e tij dhe zgjodhi të rikthehet te Cagliari", thuhet në njoftimin e klubit italian. 31-vjeçari u largua nga Cagliari për t'u transferuar në Romë ku u bë një nga mesfushorët më të njohur në botë para se edicionin e kaluar t'i bashkohet Interit. Për "Ninjan" në garë ishin edhe Fiorentina dhe skuadra kineze.



AGJENCIA
PËR INVESTIME
DHE PËRKRAHJEN
E NDËRMARRJEVE
NË KOSOVË

KIESA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e produkteve të drurit masiv "M.O.W.", në Bad Salzflun, Gjermani më 15-19 shtator 2019

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese për dy (2) subjekte pjesëmarrëse ndërsa shpenzimet e tjera do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri më datë 16.08.2019 dhe vetëm aplikacionet e plotësuar tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

- Për të aplikuar duhet dorëzuar:
 - Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
 - Dokumentet e kërkuara.
- Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
 - Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
 - Dëshminë e xhirlogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
 - Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
 - Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetim (kërkohet origjinali, jo më i vjetër se 30 ditë).
 - Deklaratën në betim;
 - Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2018 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
 - Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

- Dy (2) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
 - Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt, tre (3) pikë për dy produkte, pesë (5) pikë për tri (3) produkte, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
 - Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, dhe gjuhët tjera pesë (5) pikë;
 - Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze pesë (5) pikë dhe pesë (5) pikë në gjuhët tjera evropiane;
 - Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2017 dhe 2018, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së pesë (5) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) tri (3) pikë dhe tregjet e tjera dy (2) pikë;
 - Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulative: FSC CoC dy (2) pikë, ISO 14001 dy (2) pikë dhe certifikim tjetër relevant një (1) pikë;
 - Paraqitja e subjektit aplikues në panair tri (3) vitet e fundit, maksimum pesë (5) pikë: një panair një (1) pikë, dy (2) panair dy (2) pikë, tri (3) panair tri (3) pikë, katër (4) panair katër (4) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair pesë (5) pikë;
 - Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2018, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 13.08.2019, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 16.08.2019 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rruga Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MTI apo të shkarkohen nga faqet e internetit mti.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.



AGJENCIA
PËR INVESTIME
DHE PËRKRAHJEN
E NDËRMARRJEVE
NË KOSOVË

KIESA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria

Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

U cilju promocije Kosovskih proizvodnih preduzeča u pronalazenju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Trgovine i Industrije putem Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzečima (KIESA), najavljuje

Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu proizvoda masivnog drveta "M.O.W.", u Bad Salzflun, Nemačka, od 15-19 septembra 2019

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzečima (KIESA), koja pokriva troškove izložbenog prostora za dva (2) učesnika dok ostale troškove preduzimaju sami učesnici.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja posla do 16.08.2019 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

- Da biste aplicirali treba dostaviti:
 - Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
 - Potrebne dokumente.
- Potrebni dokumenti za apliciranje:
 - Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
 - Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
 - Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
 - Uverenje Suda da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom (potrcban je original, ne stariji od 30 dana);
 - Izjava pod zakletvom;
 - Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2018 od strane Poreske Administracije Kosova; i
 - Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

- Dva (2) učesnika bit će odabrani prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
 - Proizvode koje će aplikant pružiti potencijalnim kupcima na sajmu, maksimalno deset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) proizvod, tri (3) poena za dva proizvoda, pet (5) poena za tri (3) proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više proizvoda;
 - Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, i drugi jezici pet (5) poena;
 - Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom jeziku pet (5) poena, i pet (5) poena na drugim Evropskim jezicima;
 - Države u kojima su proizvodi aplikanta izvezeni tokom 2017 i 2018, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: države članice EU pet (5) poena, države Zapadnog Balkana koje nisu članice EU (Albanija, Bosna i Hercegovina, Srbija, Crna Gora i Makedonija) tri (3) poena i druga tržišta dva (2) poena;
 - Međunarodna sertifikacija aplikanta, maksimalno pet (5) kumulativnih poena: FSC CoC dva (2) poena, ISO 14001 dva (2) poena i druge relevantne sertifikacije jedan (1) poen;
 - Prezentacija aplikanta na sajmovima u poslednje tri (3) godine, maksimalno pet (5) poena: jedan sajam jedan (1) poen, dva (2) sajmovi dva (2) poena, tri (3) sajmovi tri (3) poena, četiri (4) sajmovi četiri (4) poena i pet (5) i više sajmovi pet (5) poena;
 - Godišnji promet aplikanta tokom fiskalne godine 2018, maksimalno deset (10) poena: od nule do 500.000 evra četiri (4) poena; od 500.001 do 1.000.000 evra osam (8) poena i preko 1.000.000 evra deset (10) poena;

Dana 13.08.2019, u 14:00 časova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESA će odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 16.08.2019 u kancelariji Arhive Ministarstva Trgovine i Industrije, Ulica: Muharrem Fejza, Bolnički okrug, bb Priština, 10000, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MTI ili preuzeti sa veb stranice mti.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale/Kosovska Agencija za Medicinske
Proizvoda/Kosovo Medicines Agency

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

SHPALLJA E REKRUTIMIT

Institucioni: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale/ Kosovska Agencija za
Lekove i Medicinske Proizvoda/ Kosovo Medicines Agency

Departamenti: Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm
Titulli i vendit të punës: Asistent/c Ekzekutiv/c në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm
Kategoria funksionale/Grada: Koficijenti - 8
Afati i kontratës: Nëpunës i karricës – me kohë të pa caktuar
Nr. i Referencës: AKPPM 07/08/2019

Detyrat kryesore:

- Ofron mbështetje të shumëllojshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve si dhe pritjen e palëve për eprorin ;20%
- Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet agjendat dhe e-malet sipas kërkesës dhe rekomandimeve të eprorit; 20 %
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën e cila i drejtohet zyrës së drejtuesit të lartë si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj ; 15%
- Ruan dhe mirëmban kopjet elektronike dhe fizike të dokumenteve të ndryshme, dosjeve dhe të dhënave tjera me qëllim të dokumentimit të aktiviteteve të eprorit; 15%
- Mban kontakte në emër të eprorit me punonjësit e institucionit, zyrtarët e lartë, dhe publikun, përfshirë ofrimin e ndihmës dhe këshillave e udhëzimeve për çështje të caktuara ose shkëmbim të informatave; 10%
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera të eprorit si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik; 10%
- Kujdeset për sigurimin e mjetet e nevojshme financiare për shpenzimet e zyrës së drejtuesit të lartë dhe plotësimin e raporteve të shpenzimeve si dhe të jetë e furnizuar me materiale dhe pajisje, inventar të nevojshme ;5 %
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5 %

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare në, Ekonomik, Juridik, Administratë Publike ose Drejtime Shkencore.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde profesionale në një fushë të njohur administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin profesional dhe administrativ;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 06.08.2019 deri 20.08.2019.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në zyrën e resurseve humane numer 1b, adresa: rrethi i spitalit p.n.(Q.K.U.K), 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 038 200-24 -269.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale/Kosovska Agencija za Medicinske
Proizvoda/Kosovo Medicines Agency

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

OGLAS ZA REGRUTOVANJE

Institucija: Kosovska Agencija za Lekove i Medicinske Proizvode
Departman: Kancelarija Generalnog Direktora
Naziv radnog mesta: Ekzekutivni asistent u kancelariji Generalnog Direktora
Funkcionalna kategorija/Gradiranje: Koeficijent - 8
Rok ugovora: Karijerni službenik – na neodređeno vreme
Br.reference: KAMP 07/08/2019

Glavni zadaci:

- Pružna razne administrativne i tehničke podrške, uključujući službenu poštu, telefonske pozive, skeniranje, faksiranje i kopiranje dokumenata, kao i prijem stranaka;
- Priprema i modifikuje dokumente uključujući prepisku, izveštaje, memorandum, dnevni red i e-poštu na zahtev i preporuke nadzornika; 20%
- Prima i distribuira prepisku upućenu kancelariji izvršnog direktora i brine se o njenom održavanju; 15%
- Održava i održava elektronske i fizičke kopije različitih dokumenata, dosjea i drugih podataka u svrhu dokumentovanja superiornih aktivnosti; 15%
- Održava kontakte u ime supervizora sa osobljem ustanove, visokim zvaničnicima i javnošću, uključujući pružanje pomoći i savetovanja o određenim stvarima ili razmenu informacija; 10%
- Upravlja kalendarom sastanaka i drugim događajima supervizora i pomaže u rešavanju svih administrativnih i tehničkih problema; 10%
- Osigurava obezbeđivanje potrebnih finansijskih sredstava za troškove kancelarije višeg rukovodioca i popunjavanje izveštaja o troškovima, kao i snabdevanje materijalima i opremom, potrebnim inventarom;
- Obavlja i druge dužnosti u skladu sa zakonima i drugim propisima koje Supervisor može s vremena na vreme tražiti; 5%

Zahtevano školovanje: Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne uprave ili naučne oblasti.

Sposobnosti / iskustvo i drugi zahtevani atributi :

- Najmanje tri (3) godine profesionalnog iskustva;
- Poznavanje standardnih profesionalnih postupaka u administrativnoj oblasti;
- Sposobnost za rad na samoinicijativi u okviru definisanih planova i procedura;
- Dobre komunikacijske veštine, uključujući sposobnost tumačenja informacija, pružanja instrukcija i prenošenja informacija drugima;
- Sposobnost koordinacije i nadzora rada osoblja na profesionalnom i administrativnom nivou;
- Kompjuterske veštine u primeni programa (Word, Excel, Power Point, Access, Interneta);

Uslovi za učesće u regrutovanju: Pravo aplikacije imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koji su završili adekvatno školovanje i koji imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje : Na osnovu Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi na Kosovu kao i Uredbe br.02/2010 o proceduri regrutovanja u civilnoj službi.

Datum publikacije i zatvaranja konkursa: 06.08.2019 deri 20.08.2019.

Prijave aplikacija: Aplikacije se mogu dobiti na Kancelariji za ljudske resurse br. 1b, adresa: Bolnički okrug p.n. (Q.K.U.K), 10000 Priština, Republika Kosovo.

Na aplikaciji jasno navedite naziv radnog mesta i broj reference. Kontaktirati na telefon : 038 200-24 -269.

"Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova, i prima aplikacije od osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.

